



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3153/6 prot.

Datë 18.11.2025

V E N D I M
Nr. 1696/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770- 10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara., me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Ankimues: Operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK me NIPT (K41420001V), me adresë: Autostrada Tirane Durrës, Km 6, Ndertesa dy kateshe nr. 5, kati i I i ndertesës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 2 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.06.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-51922-06-20-2025, me objekt “Blerje tubo naftës-jellësi”, me fond limit 20,832,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-07-2025 nga autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol.

II.2. Në datë 22.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 27.10.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--------------------------------------|--------------|
| 1. OE “E v i t a” sh.p.k | Skualifikuar |
| 2. OE “M E D I C A M E N T A” sh.p.k | Skualifikuar |

II.4. Në datën 03.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar anulimin e procedurës nepermjet buletinit të njoftimeve publike nr.69 datë 10.11.2025 të Agjesisë e prokurimit publik me arsyen si më poshtë vijon :

“6. Arsyet e Anulimit: Në zbatim të gërmës b), të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, për arsye se në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

7. Informacion shtesë: Loti 4 Magnesium sulphate me nr. REF-63770-10-06-2025, rezultoi se ka marrë pjesë : 1. “M E D I C A M E N T A” sh.p.k me NUIS K41420001V 2. OE “E v i t a” sh.p.k me NUIS L31714005J

Është skualifikuar : 1. OE “M E D I C A M E N T A” sh.p.k me NUIS K41420001V. - OE nuk plotëson pikën 4 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit pasi: Autorizimi për tregtim nr. 7701/42 prot. dt. 22.12.2022 i barit farmaceutik “Manitol” lëshuar nga AKBPM për subjektin “MONICO” është në formëdozën 18% dhe jo në formëdozën 20%-250 ml, siç kërkohet në shtojcën 6 formulari i specifikimeve teknike të dokumuneteve të tenderit.”

II.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6048, datë 05.11.2025 dhe me nr. protokoli 3153/2025 datë 05.11.2025 e operatorit ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770-10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 3153/1 datë 06.11.2025, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur 2 nga operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me anë të sistemit elektronik të ankesave është përcjellë shkresa nr. 3188/29 prot., datë 13.11.2025, me objekt “Informacion”, protokolluar prane Komisionit te Prokutimit Publik me nr.3153/2 prot., datë 13.11.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

II.8. Me shkresën nr.3188/30 datë 13.11.2025 autoriteti kontraktor ka përcjellë më anë të postës shkresën me përmbajtje të njëjtë me atë të përcjellë nëpërmjet sistemit, protokolluar

prane Komisionit te Prokurimit Publik me nr.3153/3 prot., datë 14.11.2025, ku konstatohet se ka vendosur pranimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “M E D I C A M E N T A” SHPK, per shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të sistemit elektronik të ankesave eshte përcjellë shkresa nr. 3188/29 prot., datë 13.11.2025, me objekt “Informacion”, protokolluar prane Komisionit te Prokurimit Publik me nr.3153/2 prot., datë 13.11.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës si më poshtë vijon:

[...]

II.

Komisioni i vlerësimit të analizës

Pas shqyrtimit të analizës, dokumentimit të parapërgatitur në SPE si dhe informacionit të shitjes në dispozicion nga njësia e prokurimit:

ARSYETON:

Duke pretenduar se operatori ekonomik i ankimuesve "MEDICAMENTA" shpk ka për qëllim shqyrtimin e shitjes nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të tij, me arsyen se nuk mund të përfundojnë teknikat specifike me autorizim për tregtimin e parapërgatitur, KSHA ka për qëllim:

Në Shtojcën 6 "Formularët e Teknikave Specifike" të Dokumenteve të Tenderit është përdorur si më poshtë:

Nr. Loti

Sistemi Parimet aktive

Formedoza

Njësia

Loti 4Barna Gjaku dhe organet e formuara të gjakutManitol20%-250 mlFlakon

Ndërsa në pikën 2.3.4 është përdorur: "Për barnat (e listës së DST) të autorizuar për treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

Dokumentet e konfirmuara nga ligji i ofruar, janë të autorizuar për tregti në Republikën e Shqipërisë, të lëshuara nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe e Pajisjeve Mjekësore ose/autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë."

Në procesverbalin "Për Argumentimin Dhe Miratimin E Specifikimeve Teknike Dhe Kriteve Për Kualifikim", lidhur me kriterin e mësipërm është parashikuar:

"Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me Nenin 11 të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar, ku në pikën 1 të këtij neni citohet:

"1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia."

Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentet Rinovim i Autorizimit për Tregëtim nga kompanitë OSEL, Monico dhe Profarma me emërtimet si më poshtë:

Nga shqyrtimi i tyre, KSHA konstaton se operatori ekonomik ankimues përmbush kriterin e sipërcituar me paraqitjen e dokumentit "Rinovim i Autorizimit për Tregëtim" për kompaninë OSEL ILAÇ SAN. VE TIC. A.S. dhe dokumentit "Rinovim i Autorizimit për Tregëtim" për kompaninë PROFARMA sha, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Sa i takon dokumentin "Rinovim i Autorizimit për Tregëtim" për kompaninë MONICO S.P.A. lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, KSHA ashtu si edhe KVO, konstaton një mospërputhje lidhur me specifikimet teknike. Konkretisht në dokumentin Rinovim i Autorizimit për Tregëtim të kompanisë Monico konstatohet një mospërputhje e specifikimeve teknike pasi përbërësi aktiv i artikullit Mannitol rezulton 18% dhe jo 20%, sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit.

KSHA vlerëson se operatori ekonomik, në përmbushje të kriterit si dhe përputhshmërisë së specifikimeve teknike me kërkesat e DT, ka deklaruar se do të furnizojë autoritetin kontraktor përfitues me përqendrimin e artikullit në formëdozën e kërkuar në DT. Gjithashtu, edhe në Formularin e Ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet ofertimi i produktit me përqendrimin e përcaktuar në Shtojcën 6.

KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues, me dokumentacionin e dorëzuar ka dëshmuar se përmbush kriterin e sipërcituar si dhe specifikimet teknike të artikullit të përcaktuar në Shtojcën 6 të DT nga shoqëritë prodhuese OSEL ILAÇ SAN. VE TIC. A.S. dhe PROFARMA sha.

KSHA thekson se medikamenti Manitol i pasqyruar në dokumentin Rinovim i Autorizimit për Tregëtim me kompaninë Monico nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën

6 dhe rrjedhimisht nuk duhet të jetë pjesë e kontratës në rast se operatori ekonomik ankimues shpallet fitues.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Baza në nenin 114 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ndaluar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "MEDICAMENTA" shpk.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar **dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.**

III.1.3. Neni 115, pika 3 e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar parashikon shprehimisht se : "3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji; b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor."

III.1.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr. 3153/2 prot., datë 13.11.2025, me objekt "Informacion", protokolluar prane Komisionit të Prokurimit Publik me nr.3153/2 prot., datë 13.11.2025, ku autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e ankesës, kështu që rrjedhimisht Komisioni **do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me ankesën nr. A/2025/6048, datë 05.11.2025 dhe me nr. protokoli 3153/2025 datë 05.11.2025 e operatorit ekonomik "M E D I C A M E N T A" SHPK** në procedurën e prokurimit së sipërcituar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në

një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770-10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me këtë vendim dhe konstatimet e Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për operatorin ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

